



KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr.03, datë 22.02.2018

Për caktimin e shoqërisë “Deloitte Audit Albania sh.p.k.” si auditues i jashtëm i specializuar i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin financiar 2017, me të drejtë rinovimi për vitet financiare 2018, 2019, 2020

Në mbështetje të nenit 52, pika 1, shkronja “j”, të nenit 62, pika 1, dhe të nenit 63, pika 1 të ligjit 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave” të ndryshuar, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, Këshilli Drejtues

V E N D O S I:

1. Të caktojë shoqërinë “Deloitte Audit Albania sh.p.k.” si auditues të jashtëm të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin financiar 2017, me të drejtë rinovimi për vitet financiare 2018, 2019, 2020, kundrejt përmbushjes së kënaqshme të shërbimit.
2. Të autorizojë Drejtorin e Përgjithshëm për nënshkrimin e kontratës me shoqërinë “Deloitte Audit Albania sh.p.k.”.
3. Të autorizojë Drejtorin e Përgjithshëm për njoftimin e Autoritetit Mbikëqyrës, për caktimin e shoqërisë “Deloitte Audit Albania sh.p.k.” për auditimin e pasqyrave financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për vitin financiar 2018, me të drejtë rinovimi për vitet financiare 2019 dhe 2020, kundrejt përmbushjes së kënaqshme të shërbimit.
4. Të autorizojë Drejtorin e Përgjithshëm, që të caktojë punonjësit e Agjencisë për ndjekjen e zbatimit të kontratës me shoqërinë “Deloitte Audit Albania sh.p.k.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

Sekretar

Donald Duraj

Kryetar